

STATUTI
LUMOS SH.P.K.
Shoqëri me Përgjegjësi te Kufizuar

Ne këtë statut

- "Ligji" është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtaret dhe Shoqëritë tregtare";
- "Statuti" është Statuti i shoqërisë;

Kreu I: Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1: Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

- (1) Sot, me 16.11.2023, unë, themeluesi, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi te kufizuar me emrin "LUMOS" SH.P.K.
- (2) Themeluesi i shoqërisë është:

- Bledar Mankollari, Rruga RINIA; Nd. 23; H. 7; Ap. 2; MALIQ; MALIQ; 7005; MALIQ

Neni 2: Objekti

Shoqëria do te kryeje aktivitetin e mëposhtëm:

- Financimin, Investimin, projektimin, operimin, ndërtimin, vënien ne pune, administrimin mirëmbajtjen e impianteve fotovoltaike dhe prodhimin, furnizimin transmetimin shpërndarjen, importimin dhe eksportimin dhe shitjen e energjisë elektrike. Konsulencë, supervizim, projektim, mirëmbajtje dhe realizim i impianteve te prodhimit te energjisë elektrike. Shoqëria ka te drejtë te ushtrojë çdo lloj aktiviteti te parashikuar nga ligji ne përputhje me rregullat e dispozitat ne fuqi.

Neni 3: Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do te jetë e pacaktuar.



Neni 4: Selia

1. Selia e shoqërië ndodhet ne adresën: - Rruga Dervish Hima Nr. 78, H. 1, Ap.1, Burrel, 8001, Mat.
2. Adresa e faqes se internetit te shoqërisë është: www.lumos.al
3. Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: lumos.shpk@gmail.com

Kreu II

Kapitali Neni 5: Kapitali themeltar

(1) Kapitali themeltar fillestari i shoqërisë është 100 Lek. Pjesëmarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqërisë është ne përputhje me kontributet e tyre te mëposhtme:

- Ortaku themelues Bledar Mankollari: Zotëruar i 1 (një kuote) me vlere te përgjithshme 100 Lek qe përbën 100 % te kapitalit themeltar te shoqërisë.

Neni 6: Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit.

Kapitali i shoqërisë mund te zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve te pjesëve te kapitalit themeltar për kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës se administratorit.

Ne asnjë rast shumica nuk mund te detyroje një ortak për te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve e cila merr vendim ne te njëjtat kushte qe kërkohen për ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët ne te njëjtën mase ndaj pjesëve te kapitalit qe përfaqësojnë.

Neni 7: Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit te një shoqërie me përgjegjëses te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nëpërmjet:

a) kontributit ne kapitalin e shoqërisë;



- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyre tjetër te parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht te transferueshme ndërmjet ortakeve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht te transferueshme me rruge trashëgimie.

KREU III Organet Vendimmarrëse dhe Drejtuese

Neni 8: Organi Vendimmarrës

- 8.1. Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
- 8.2. Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.
- 8.3. Asambleja e per gjithshme e ortakeve eshte per gjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per çeshtjet e me poshtme:
 - a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
 - ç) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
 - d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat “c” dhe “ç” te kesaj pike;
 - dh) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire per gatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - e) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
 - f) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
 - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
 - h) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
 - i) çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.
- 8.4. Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e per gjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete.
- 8.5. Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaquesues i ortakeve ne asamblene e per gjithshme.
- 8.6. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se

pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Neni 9: Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblesë se Përgjithshme

9.1. Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet një njoftimi me shkrese ose, nese parashikohet nga statuti, me njoftim nepermjet postes elektronike.

Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

9.2. Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakord, për te marre vendime, pavaresisht parregullsise.

Neni 10: Kuorumi

10.1. Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne një shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave.

10.2. Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per çeshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

10.3. Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumit te permendor me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

Neni 11: Marrja e vendimeve

11.1. Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

11.2. Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per çeshtje te tjera si :

- a) percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;
- b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- c) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- ç) percaktimin e shperblimeve



- d) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire perqatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - e) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- 11.3. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 12 Perjashtimi nga e drejta e votes

12.1. Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendim per:

- a) vleresimin e veprimtarise se tij;
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij;
- c) ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria;
- ç) dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

12.2. Kur ortaku perfaqeshet nga nje perfaquesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

Neni 13 Administrimi

13.1. Asambleja e pergjithshme emeron nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit, eshte 2 vjet, me te drejte riperteritjeje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

13.2. Administratoret e nje shoqerie tregtare meme, sipas percaktimit te nenit 207 te ketij ligji, nuk mund te emerohen si administratore te nje shoqerie te kontrolluar e anasjelltas. Çdo emerim i bere ne kundershtim me keto dispozita eshte i pavlefshem.

13.3. Bledar Mankollari me Nr. Id. H80227195M është Administrator i shoqërisë.

Neni 14: Kompetencat e Administratoreve

14.1. Administratoret kane te drejte e detyrohen te:

- a) kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme;
- b) perfaqesojne shoqerine tregtare;
- c) kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;

ç) pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se per gjithshme per miratim; d) krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise; dh) kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, siç parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit; e) raportojne perpara asamblese se per gjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendesi te veçante per veprimtarine e shoqerise tregtare; e) kryejne detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

14.2. Administratoret jane te detyruar te therasin Asamblene e Pergjitheshme, ne rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.

-shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

-shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

14.3. Nese asambleja e per gjithshme emeron me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine.

14.4. Asambleja e per gjithshme mund te shkarkoje administratorin ne çdo kohe me shumice te zakonshme. Padite, qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Neni 15: Pergjegjesite e Administratorit

15.1. Administratori eshte per gjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

15.2. Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

15.3. Perveç sa eshte parashikuar ne dispozitat e per gjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite

Tregtare“, administrator detyrohet:

- 15.3.1. a) te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te veçante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis;
- b) te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;
- c) te vleresoje me perjegjesi çeshtjet, per te cilat merret vendim;
- ç) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ata te shoqerise;
- d) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshem.

15.3.2. Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, perjigjen ndaj shoqerise per çdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

15.3.3. Nese administratori vepron ne kundershtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 te ketij neni, eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje çdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt e sipas standardeve te kerkuara. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata perjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidare.

15.4. Ne menyre te veçante, por pa u kufizuar ne to, administratori eshte i detyruar t'I demshperbleje shoqerise demet e shkaktuara, nese, ne kundershtim me dispozitat e ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” , kryen veprimet e meposhtme:

- a) u kthen ortakeve kontributet;
- b) u paguan ortakeve interesa apo dividende;
- c) u shperndan aktivet shoqerise;
- ç) lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare, kur, ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

15.5. Perveç padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise, perfshire edhe demshperblimin financier, nese eshte e nevojshme. Asnje vendim i asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkesa padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

KREU IV: Viti finansiar-ekspertet

Neni 16: Viti Financiar

16.1. Viti finansiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti I pare finansiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllt me 31 Dhjetor.

Neni 17: Ekspertet

17.1. Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithevetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

17.2. Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar perbatit reportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit finansiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'I shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

KREU V Prishja, riorganizimi i shoqërisë

Neni 18: Prishja dhe likuidimi

18.1. Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelin e saj;
- b) me vendim te Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit;
- ç) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi I veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit";
- d) me vendim te gjykates;

18.2. Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

18.3. Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

18.4. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga Ortaket.

18.5. Nese Ortaket nuk merrin një vendim për emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, për të caktuar një likuidues.

Neni 19: Riorganizmi i shoqerise bashkimi-ndarja

19.1. Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare."

Neni 20: Baza Ligjore

20.1. Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar.

20.2. Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Nenl 21 Mosmarrëveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per do mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Emri dhe nënshtkrimi i Ortakut Themelues:

Bledar Mankollari

(Emer Mbiemer)



(Nenshkrimi)